

Përmbledhje e dobishme për muslimanin e ri



Përgatiti
Muhamed esh-Shehri



Libër interaktiv për
celular

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit



**Kliko për të shkuar
te tema**



Allahu është Zoti im



Profeti im është Muhamedi



**Kurani i madhërishëm
është Fjala e Zotit tim**






**Kliko për të shkuar
te tema**



**Të njihemi me shtyllat e
Islamit**



**Të njihemi me shtyllat e
besimit**



Mësoj abdesin





**Kliko për të shkuar
te tema**



**Mes'hi (fshirja) mbi mestet
e lëkurës dhe çorapet**



**Gusli
(larja e plotë e trupit)**



**Tejemumi
(pastrimi simbolik me dhe')**






**Kliko për të shkuar
te tema**



Mësoj namazin



**Hixhabi (mbulesa) i gruas
muslimane**




Cilësi të besimtarit





**Kliko për të shkuar
te tema**



**Lumturia ime është në fenë
time, Islamin**





Lavdërimi absolut i takon vetëm Allahut; Atë e lavdërojmë; prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu nga ligësitë e vetes dhe nga veprat tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon, askush nuk mund ta devijojë; dhe atë që Ai e lë në humbje, askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Ai është i Adhuruari i Vërtetë, i Vetëm, që s'ka asnjë shok; dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.



E në vijim:

Allahu i Lartësuar i ka nderuar bijtë e Ademit dhe i ka dalluar mbi shumë prej krijesave. Allahu i Lartësuar thotë: {Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit} [El Isra: 70]. Ai gjithashtu e shtoi nderimin e këtij umeti duke dërguar tek ata Profetin më të mirë, Muhamedin ﷺ (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), dhe duke zbritur Librin më të mirë – Kuranin e madhërishëm, dhe zgjodhi për ta fenë më madhështore që ka legjitimuar, Islamin. Allahu i Lartësuar thotë: {Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë} [Al Imran: 110].



Ndër begatitë e mëdha të Allahut ndaj njeriut është që t'ia mundësojë atij udhëzimin në Islam, qëndrueshmërinë në të dhe zbatimin e rregullave dhe ligjeve të tij. Në këtë libër, të vogël nga madhësia por i madh nga përmbajtja, i sapoudhëzuari mëson gjëra që nuk i lejohet t'i injorojë në fillimet e tij në Islam. Libri ka një stil të përmbledhur që sqaron parimet e kësaj feje madhështore. Pasi t'i ketë kuptuar dhe të veprojë sipas tyre, mund të nisë kërkimin e dijes dhe të shtojë diturinë, në mënyrë që njohuria e tij për Allahun e Lartësuar, për Profetin Muhamed ﷺ dhe fenë e tij, Islamin, të shtohet. Kështu do ta adhurojë Allahun e Lartësuar me syçelësi dhe dije; zemra e tij do të qetësohet dhe besimi do t'i shtohet, teksa është gjithmonë duke iu afruar Allahut të Lartësuar me adhurim dhe duke ndjekur me përpikmëri Sunetin e Profetit të Tij Muhamed ﷺ.



Allahut të Lartësuar i lutem të bekojë
çdo fjalë në këtë libër, që libri të jetë i
dobishëm për Islamin dhe muslimanët,
që kjo vepër të jetë krejtësisht e sinqertë
për hir të Allahut dhe t'i shpërblejë
të gjithë muslimanëve, të gjallëve e të
vdekurve.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin
mbi Profetin tonë Muhamed, mbi
familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Muhamed esh-Shehri

1441 – 2020



ذِي كَلَامٍ

Allahu është
Zoti im





- Allahu i Lartësuar thotë: {O ju njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve dhe ata që ishin para jush, në mënyrë që të bëheni të përkushtuar} [ElBekare: 21].
- Allahu i Lartësuar thotë: {Ai është Allahu; nuk ka hyj tjetër përveç Tij} [El Hashr: 22].
- Allahu i Lartësuar thotë: {Nuk ka të ngjashëm me Të; Ai është Gjithëgjuesi, Gjithëshikuesi} [Esh-Shura: 11].
- Allahu është Zoti im dhe Zoti i gjithçkaje; Ai është Sunduesi, Krijuesi, Furnizuesi dhe Drejtuesi i çdo gjëje.
- Vetëm Ai meriton adhurimin; nuk ka zot dhe as hyj tjetër përveç Tij.





- Atij i takojnë emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta, të cilat Ai i pohoi për Vetën dhe ato që Profeti ﷺ ia atribuoi Atij. Emrat e cilësitë e Tij kanë arritur kulmin e përsosmërisë dhe bukurisë. Nuk ka të ngjashëm me Të; Ai është Gjithëdëgjuesi, dhe Gjithëshikuesi.

Ja disa prej emrave të Tij të bukur:

**ER-RAZZAAK, ER-RAHMAN, EL KADIIR,
EL MELIK, ES-SEMI', ES-SELAM, EL-BESIR,
EL UEKIIL, EL KHALIK, EL-LATIIF, EL KAFII,
EL GAFUUR.**





ER-RAZZAAK – Furnizuesi:

Ai që u garanton ushqimin robërve të Vet, me anë të të cilit sigurohet jetëgjatësia e mbarëvajtja e zemrave dhe trupave të tyre.

ER-RAHMAN-i Gjithëmëshirshmi:

Ai që zotëron mëshirë të gjerë e madhështore, e cila ka përfshirë çdo gjë.

EL KADIIR – i Gjithëfuqishmi:

Ai që ka fuqi absolute; Ai që nuk preket nga dobësia apo lodhja e plogështia.

EL MELIK – Sunduesi:

Ai që ka cilësitë e madhështisë, fuqisë mbizotëruese dhe planifikimit. Ai është Pronari i të gjitha gjërave dhe ka kontroll absolut mbi to.

ES-SEMI' - Gjithëdëgjuesi:

Ai që dëgjon të gjitha gjërat e dëgjueshme, si të fshehta ashtu edhe të hapura.





ES-SELAM - Dëliri, i Përsosuri:

Ai që është i përkryer; nuk ka asnjë të metë apo mangësi.

EL BESIR – Gjithëshikuesi:

Ai që me shikimin e Vet ka përfshirë çdo gjë, sado e imët apo e vogël qoftë; me depërtueshmëri dhe dijeni të plotë për të gjitha gjërat, i informuar për të fshehtat e tyre.

EL UEKIIL – Përkujdesësi:

Ai që u garanton krjesave të Tij furnizimin dhe kujdeset për interesat e tyre; Ai që përkujdeset për miqtë e Tij të dashur, duke ua ka lehtësuar punët dhe duke u mjaftuar atyre në çdo gjë.

EL KHALIK – Krijuesi:

Ai që sjell në ekzistencë gjërat dhe i krijon ato pa ndonjë model të mëparshëm.





EL-LATIIF - i Buti, Bamirësi pa kufi:

Ai që i nderon robërit e Tij, i mëshiron dhe ua plotëson kërkesat.

EL KAFII-i Mjaftueshmi:

Ai që u mjafton robërve të Vet për gjithçka që ata kanë nevojë. Ndihma e Tij është e mjaftueshme për të gjithë. Nëse krijesat mbështeten tek Ai, atyre nuk iu nevojitet askush tjetër; i bën ata të pavarur nga çdokush veç Tij.

EL GAFUUR - Falësi i madh:

Ai që i mbron robërit e Vet nga e keqja e mëkateve të tyre dhe nuk i ndëshkon për to.





Muslimani mediton rreth krijimit të mrekullueshëm të Allahut dhe lehtësimit të jetesës që Ai ua garanton krijesave. Ndër këto është dhe kujdesi i krijesave për të vegjlit e tyre. Kjo përkujdesje realizohet përmes një sjelljeje të denjë me përkushtim të madh për t'i ushqyer dhe për t'iu shërbyer, derisa të bëhen të aftë të kujdesen për veten e tyre.

I Lartësuar qoftë Ai – Krijuesi i tyre, Bamireshi pa kufi! Me mirësinë e butësinë e Tij, u ka përgatitur krijesave gjithçka që i ndihmon dhe përmirëson gjendjen e tyre, edhe pse janë krejtësisht të dobëta.



نَبِيٌّ مُحَمَّدٌ
صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

Profeti im është Muhamedi

صَلَّى اللَّهُ
عَلَيْهِ وَسَلَّمَ





Allahu i Lartësuar thotë: {Juve ju ka ardhur një Profet nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë nga vuajtjet tuaja, sepse ai e dëshiron fort rrugën e drejtë për ju. Për besimtarët, ai është shumë i ndjeshëm dhe i mëshirshëm} [Et-Teube: 128].



- Allahu i Lartësuar thotë: {Ne të dërguam ty (o Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha botët} [ElEnbija: 107].

Muhammedi ﷺ – mëshira e dhuruar

Ai është Muhamedi ﷺ, i biri Abdullahit, vula e profetëve dhe e të dërguarve. Allahu i Lartësuar e dërgoi atë me fenë islame tek të gjithë njerëzit, për t'i udhëzuar drejt mirësisë - më e madhja mirësi është teuhidi (njësimi i Allahut), dhe për t'i larguar nga e keqja – e keqja më e madhe është shirku (idhujtaria).

Është detyrë t'i bindemi atij në çdo gjë që urdhëron, t'i besojmë në gjithçka që lajmëron, të largohemi nga çdo gjë që ndalon dhe dhe ta adhurojmë Allahun vetëm në mënyrën e ligjësuar prej tij.

Mesazhi i Muhamedit ﷺ dhe i të gjithë profetëve para tij është thirrja për të adhuruar vetëm Allahun, i Cili nuk ka asnjë ortak.





Disa nga cilësitë e tij ﷺ:

- Singëriteti.
- mëshira.
- butësia.
- durimi.
- trimëria.
- bujaria.
- morali i mirë.
- drejtësia.
- modestia.
- falja.



الْقُرْآنُ الْكَرِيمُ كَلَامُ رَبِّي

**Kurani i
madhërishëm
është Fjala e
Zotit tim**





Allahu i Lartësuar thotë: {O njerëz!
Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë
e madhe nga Zoti juaj dhe Ne ju kemi
zbritur një dritë të qartë} [En-Nisa: 174].





Kurani i madhërishëm është Fjala e Allahut të Lartësuar, të cilën ia shpalli Profetit Muhamed ﷺ, për t'i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë dhe për t'i udhëzuar në Rrugën e Drejtë.

Kush e lexon atë, fiton shpërblim të madh; dhe kush vepron sipas udhëzimit të tij, ecën në rrugën e drejtë.



تَعْرِفُ عَلَى أَرْكَانِ الْإِسْلَامِ

Të njihemi me shtyllat e Islamit





I Dërguari ﷺ ka thënë:

“Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë”.

Shtyllat e Islamit janë akte adhurimi të detyrueshme për çdo musliman. Nuk është i vlefshëm Islami i një personi derisa të besojë në obligueshmërinë e tyre dhe t'i kryejë ato të gjitha. Ky gjykim bazohet në faktin se Islami është ndërtuar mbi këto adhurime, prandaj ato quhen shtyllat e Islamit.

Këto shtylla janë:



Shtyllat e Islamit

1



**Dëshmia se nuk ka të
adhuruar tjetër me të
drejtë përveç Allahut dhe
se Muhammedi është i
Dërguari i Allahut**

2



Falja e namazit



Shtyllat e Islamit

3



Dhënia e zekatit

4



**Agjërimi i muajit
Ramazan**

5



**Haxhi në Shtëpinë e
Shenjtë të Alahut**





Shtylla e parë

Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut

- Allahu i Lartësuar thotë: {Dije pra se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut} [Muhamed: 19].
- Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: {Juve ju ka ardhur një Profet nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë nga vuajtjet tuaja, sepse ai e dëshiron fort rrugën e drejtë për ju. Për besimtarët, ai është shumë i ndjeshëm dhe i mëshirshëm} [Et-Teube: 128].



Kuptimi i dëshmisë “LA ILAHE IL-L ALLAH”: Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.

Kuptimi i dëshmisë “MUHAMED RESULULLAH - Muhamedi është i Dërguari i Allahut”: t'i bindemi atij në çdo gjë që urdhëron, t'i besojmë në gjithçka që lajmëron, të largohemi nga çdo gjë që ndalon dhe dhe ta adhurojmë Allahun vetëm në mënyrën e ligjëruar prej tij.



Shtylla e dytë

Falja e namazit

- Allahu i Lartësuar thotë: {Faleni namazin në mënyrë të përkryer!} [El Bekare: 110].
- Namazi falet në mënyrë të përkryer duke e realizuar në formën e ligjësuar nga Allahu i Lartësuar dhe ashtu siç na e ka mësuar i Dërguari i Tij, Muhamedi ﷺ.




Shtylla e tretë

Dhënia e zekatit

- Allahu i Lartësuar thotë: {Jepeni zekatin!} [El Bekare: 110].
- Allahu i Lartësuar e bëri obligim zekatin si një provë për sinqeritetin e besimit të muslimanit, si një mënyrë për të shprehur falënderim ndaj Atij që e pasuroi dhe si një mjet për të ndihmuar të varfrit e nevojtarët.

- 
- Dhënia e zekatit realizohet duke ua dhuruar atë atyre që e meritojnë.
 - Zekati është detyrim mbi pasurinë, kur ajo arrin një shumë të caktuar; jepet për tetë kategori (përfituesish) që Allahu i ka përmendur në Kuranin e madhërishëm, duke përfshirë të varfrit dhe nevojtarët.
 - Përmes zekatit shprehet qartë e në formë konkrete mëshira dhe dhembshuria; nëpërmjet tij muslimani pastron moralin dhe pasurinë; ai i kënaq zemrat e të varfërve e nevojtarëve; si dhe forcon lidhjet e dashurisë dhe vëllazërisë, ndërmjet anëtarëve të shoqërisë islame. Prandaj muslimani i devotshëm e jep zekatin me dëshirë e gëzim, sepse u sjell lumturi të tjerëve.

- 
- Shuma e zekatit për pasurinë është 2.5% e parave të kursyera nga ari, argjendi, kartëmonedhat dhe mallrat tregtare të destinuara për blerje dhe shitje me qëllim për të fituar, nëse vlera e tyre arrin një shumë të caktuar dhe ka kaluar një vit i plotë.
 - Gjithashtu, zekati është i detyrueshëm për dikë që zotëron një numër të caktuar bagëtish (deve, lopë dhe dele), nëse kullotin pjesën më të madhe të vitit, pa u ushqyer nga pronari i tyre. Po ashtu, zekati është obligim për atë që del nga toka, siç janë: drithërat, frutat, mineralet dhe thesaret, nëse arrijnë një sasi të caktuar.



Shtylla e katërt

Agjërimi i muajit Ramazan

- Allahu Lartësuar thotë: {O ju që keni besuar! Agjërimi është detyrë për ju, sikurse ka qenë detyrë edhe për ata që ishin para jush, me qëllim që të bëheni të devotshëm} [El Bekare: 183].
- Ramazani është muaji i nëntë i kalendarit hixhri. Është një muaj që nderohet nga muslimanët dhe ka një status të veçantë në krahasim me muajt e tjerë të vitit. Agjërimi i plotë i këtij muaji është një nga pesë shtyllat e Islamit.

- 
- Agjërimi i Ramazanit është adhurimi i Allahut të Lartësuar duke u përmbajtur nga ushqimi, pija, marrëdhëniet seksuale dhe të gjitha gjërat e tjera që e prishin atë (agjërimin), prej agimit deri në perëndim të diellit, gjatë gjithë ditëve të muajit të bekuar të Ramazanit.



Shtylla e pestë

Haxhi në Shtëpinë e Shenjtë të Alahut

- Allahu i Lartësuar thotë: {Për hir të Allahut, është detyrë për njerëzit vizita e Shtëpisë, për atë që ka mundësi të shkojë tek ajo} [Al Imran: 97].

- Haxhi është i detyrueshëm një herë në jetë për ata që janë në gjendje ta kryejnë atë. Ai përfshin vizitën e Shtëpisë së Shenjtë (Qabes) dhe vendeve të shenjta në Mekën e nderuar për të kryer akte specifike adhurimi në një kohë të caktuar. Profeti Muhamed ﷺ e kreu haxhin, ashtu si edhe profetët e tjerë para tij. Allahu i Lartësuar e urdhëroi Ibrahimin ﷺ t'i thërriste njerëzit në haxh, siç na ka njoftuar për këtë në Kuranin e madhërishëm: {Thirri njerëzit që të vijnë për haxh - ata do të t'i përgjigjen thirrjes sate, duke ardhur në këmbë dhe mbi deve të lodhura, teksa përshkojnë rrugë të largëta} [El Haxh: 27].

تَعْرِفُ عَلَى أَرْكَانِ الْإِيمَانِ

**Të njihemi me
shtyllat e besimit**






Kur u pyet Profeti ﷺ për besimin, tha:
“Të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat
e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit
dhe të besosh kaderin (paracaktimin),
të mirën e të keqen e tij”.

Shtyllat e besimit janë adhurime zemre
të detyrueshme për çdo musliman. Islami
i njeriut nuk është i vlefshëm pa i besuar
ato. Kjo është arsyeja pse ato quhen
“shtyllat” e besimit. Dallimi midis tyre
dhe shtyllave të Islamit është se shtyllat e
Islamit janë veprimet e jashtme të kryera
nga një person me gjymtyrët e tij, siç është
shqiptimi i dy dëshmimeve të besimit, namazi
dhe zekati, ndërsa shtyllat e besimit janë
veprimet e brendshme të kryera me zemër,
siç janë: besimi në Allahun, në librat e Tij
dhe të dërguarit e Tij.






Kuptimi i besimit:



Besimi është bindja e patundur e zemrës në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe kaderin, çdo e mirë dhe e keqe është e paracaktuar prej Tij; si dhe ndjekja e zbatimi i çdo gjëje që solli i Dërguari ﷺ duke e shprehur me fjalë, si p.sh.: dëshmia se nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut, leximi Kuranit, lavdërimi dhe madhërimi i Allahut; po ashtu edhe veprat e dukshme që kryen me gjymtyrë, si: namazi, haxhi, agjërimi..., si dhe veprat e zemrës: dashuria për Allahun, frika prej Tij, mbështetja tek Ai dhe sinqeriteti ndaj Tij.

Ekspertët e përkufizojnë besimin shkurtimisht me këto fjalë: Bindje dhe siguri e fortë në zemër, pohim me gojë dhe veprim me gjymtyrë; shtohet përmes bindjes e nënshtrimit (ndaj Allahut) dhe pakësohet për shkak të gjynaheve.



Shtylla e parë

Besimi në Allahun

Allahu i Lartësuar thotë: {Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besuan Allahun} [En-Nur: 62].





Besimi në Allahun nënkupton teuhidin (njësimin) e Tij në rububije (duke besuar e pohuar veprat e Tij, si: krijimi, furnizimi, sundimi etj.), njësimin e Tij në uluhije (duke ia kushtuar të gjitha adhurimet vetëm Allahut) dhe njësimin e Tij në esmau eu sifat (njësimi i emrave dhe cilësive të Allahut):

- Besimi në ekzistencën e Allahut të Lartësuar.
- Besimi në rububijen e Allahut të Lartësuar se Ai është Zotëruesi e Sunduesi i çdo gjëje, Krijuesi, Furnizuesi dhe Rregulluesi i të gjitha çështjeve.
- OBesimi në uluhijen e Allahut të Lartësuar se vetëm Ai i meriton të gjitha adhurimet, pa i shoqëruar ortak; vetëm Atij i kushtohet: namazi, lutja, zotimi e kurban; vetëm prej tij kërkohet ndihmë e strehim, si dhe çdo adhurim tjetër i kushtohet vetëm Atij.





- Besimi në emrat e bukur dhe cilësitë e larta (esmau ue sifat) që Ai i ka pohuar për Vetën ose i ka pohuar për Të i Dërguari i Tij ﷺ; si dhe mohimi i atyre (emrave e ciësive) që i mohoi Vetë ose i mohoi i Dërguari i Tij ﷺ. Emrat e cilësitë e Tij kanë arritur kulmin e përsosmërisë dhe bukurisë. Nuk ka të ngjashëm me Të; Ai është Gjithëgjuesi, Gjithëshikuesi.



Shtylla e dytë

Besimi në engjëjt

Allahu i Lartësuar thotë: {I lavdëruar qoftë Allahu, Krijuesi i qiejve e i Tokës (nga asgjëja), i Cili i bëri engjëjt të dërguar me nga dy, tre e katër palë krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka} [Fatir: 1].


Besojmë se engjëjt janë një botë e padukshme; ata janë robër të Allahut, të cilët Ai i krijoi nga drita. Allahu i bëri ata të bindur e të nënshtruar ndaj Tij.





Engjëjt janë krijesa madhështore; fuqinë e numrin e tyre e di vetëm Allahu i Lartësuar. Secili prej tyre ka attribute, emra e detyra, që Allahu i Lartësuar ua ka caktuar. Midis tyre është Xhibrili عليه السلام, të cilit i është besuar shpallja dhe e zbret atë nga Zoti i Plotfuqishëm te të dërguarit e Tij.





Shtylla e tretë

Besimi në librat

Allahu Lartësuar thotë: {Thoni: 'Ne besojmë tek Allahu, tek ajo që na u shpall neve dhe tek ajo që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe Esbatëve (dymbëdhjetë bijve të Jakubit) dhe ajo që iu dha Musait e Isait dhe në gjithçka që u është dhënë profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë dallim midis asnjërit prej tyre dhe ne vetëm Atij i nënshtrohemi} [El Bekare: 136].





- Kemi bindje të sigurt se të gjithë librat qiellorë janë Fjala e Allahut.
- Në këto libra është vërteta e qartë, e zbritur nga Allahu i Lartësuar te profetët për robërit e Tij.





- Me dërgimin e Muhamedit ﷺ për gjithë njerëzit, Allahu i Lartësuar e bëri sheriatin e tij ﷺ shfuqizues të tërë sheriатеve të mëparshme, ndërsa Kuranin bëri garantues të librave qiellorë të mëparshëm dhe shfuqizues të tyre. Allahu e ka marrë përsipër ruajtjen e Kuranit nga çdo ndryshim ose shtrembërim. Allahu i Lartësuar thotë: {Ne e shpallëm Mesazhin (Kuranin) dhe sigurisht që Ne do të jemi mbrojtës të tij} [El Hixhr: 9]. sepse Kurani i madhërishëm është Libri i fundit i Allahut për njerëzimin, Profeti i Tij, Muhamedi ﷺ është i dërguari i fundit, dhe Islami feja e pranuar deri në Ditën e Kiametit. Allahu i Lartësuar thotë: {Feja e pranueshme tek Allahu është Islami} [Al Imran: 19].





**Librat qiellorë që Allahu i Lartësuar
i përmendi në Librin e Tij janë:**

Kurani i madhërishëm:

të cilin Allahu ia zbriti të Dërguarit të
Tij, Muhamedit ﷺ.

Teurati:

Allahu ia shpalli të Dërguarit të Tij,
Musait ﷺ.

Ungjilli:

Allahu ia shpalli të Dërguarit të Tij,
Isait ﷺ.

Zeburi:

Allahu ia shpalli të Dërguarit të Tij, Dautit
ﷺ.

Shkrimet e Ibrahimit:

Allahu ia shpalli të Dërguarit të Tij,
Ibrahimit ﷺ.





Shtylla e katërt

Besimi në të dërguarit

Allahu i Lartësuar thotë: {Ne çuam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: 'Adhuroni Allahun dhe lagojuni shejtanëve (adhurimit të tyre)} [En-Nahl: 36].

- Kemi bindje të sigurt se Allahu i Lartësuar çoi në çdo popull profet, që i ftonte të adhuronin vetëm Allahun, pa asnjë ortak, dhe të mos besonin në atë që adhurohet përveç Tij, të Lartësuarit.





- Të gjithë profetët janë njerëz, robër të Allahut; ata janë të singertë e të besueshëm, të devotshëm e besnikë, të udhëzuar dhe udhëzues për njerëzimin. Allahu i mbështeti ata me mrekulli, që dëshmojnë vërtetësinë e tyre. Ata e përcollën gjithçka me të cilën Zoti i dërgoi; të gjithë ishin në të vërtetën dhe udhëzimin e qartë.
- Thirrja e tyre, nga i pari deri te i fundit, u pajtua mbi parimin themelor të fesë, i cili është: njësimi i Allahut të Lartësuar në adhurim dhe distancimi nga të gjitha format e idhujtarisë.





Shtylla e pestë

Besimi në Ditën e Gjykimit

Allahu Lartësuar thotë: {Allahu është Ai që nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Tij. Pa dyshim, Ai do t'ju tubojë në Ditën e Gjykimit, për të cilën s'ka dyshim. Dhe, cili mund të jetë në fjalë më i vërtetë se Allahu?!} [En-Nisa: 87].

- Kemi bindje të sigurt në gjithçka që lidhet me Ditën e Gjykimit, ashtu siç na ka lajmëruar Zoti ynë i Lartësuar në Librin e Tij apo Profeti ﷺ, si p.sh.: vdekja, ringjallja, tubimi, ndërmjetësimi, peshoja, llogaria, Xheneti, Zjarri dhe gjëra të tjera që lidhen me Ditën e Fundit.





Shtylla e gjashtë

Besimi në kaderin – të mirën dhe të keqen e tij

Allahu i Lartësuar thotë: {Ne e kemi krijuar çdo gjë me masë të caktuar}
[El Kamer: 49].

- Kemi bindje të sigurt se të gjitha ngjarjet që u ndodhin krijesave në këtë botë janë me dijen dhe fuqinë e Zotit të Plotfuqishëm; ato ndodhin vetëm me dhe planifikimin e Tij, i Cili nuk ka asnjë partner. Besojmë se këto fate u shkruan para krijimit të njeriut; njeriu ka vullnet dhe liri në zgjedhjen e tij; ai është veprues real i veprave të tij, por asgjë nuk del nga dija e vullneti i Allahut.





Besimi në kaderin bazohet në katër nivele:

1. Besimi në dijen gjithëpërfshirëse të Allahut.
2. Besimi se Allahu ka shkruar për çdo gjë që ekziston deri në Ditën e Ringjalljes.
3. Besimi në vullnetin gjithëpërfshirës dhe fuqinë e përsosur të Allahut. Pa dyshim ajo që Ai dëshiron ndodh dhe ajo që Ai nuk dëshiron nuk ndodh.
4. Besimi se Allahu është Krijues i çdo gjëje dhe se Ai nuk ka partner në krijimin e Tij.



تَعَمَّلُوا الْوُضُوءَ

Mësoj abdesin





Allahu Lartësuar thotë: {Vërtet, Allahu i
do ata që pendohen dhe ata që pastrohen}
[El Bekare: 222].





Profeti ﷺ: **“Merrni abdes në të njëjtën mënyrë siç po veproju në”.**

Nga madhështia e namazit është se Allahu e ligjëroi pastrimin para tij dhe e bëri atë (pastrimin) kusht për vlefshmërinë e (namazit). Pastërtia është çelësi i namazit. Duke qenë i vetëdijshëm për vlerat e mëdha të namazit, zemra e muslimanit përmallohet për këtë adhurim dhe e kryen atë me përpikmëri. Profeti ﷺ ka thënë: **“Pastërtia është gjysma e besimit... dhe namazi është dritë”.**

Gjithashtu Profeti ﷺ ka thënë: **“Kush merr abdes në mënyrën më të mirë e të bukur, mëkatet e tij do t’i dalin nga trupi”.**

Në këtë mënyrë robi i afrohet Zotit përmes abdesit, i pastër fizikisht; po ashtu, i pastër edhe shpirtërisht, duke kryer këtë akt adhurimi sinqerisht për Allahun e Lartësuar dhe duke ndjekur udhëzimin e Profetit ﷺ.





Abdesi bëhet detyrë në adhurimet dhe rastet e mëposhtme:

- 1 Namazi në përgjithësi, qoftë ai i detyrueshëm apo vullnetar.**
- 2 Tauafi rreth Qabes.**
- 3 Prekja e Kuranit.**

Marr abdes dhe gusël (e laj gjithë trupin) me ujë të pastër:

Uji i pastër është ai që zbret nga qielli ose buron nga toka; ai ka mbetur në gjendjen e tij origjinale dhe asnjë nga tre karakteristikat e tij - ngjyra, shija dhe aroma - nuk ka ndryshuar nga asgjë që do ta privonte atë (ujin) nga pastërtia.





Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

1

Nijeti (qëllimi) dhe vendi i tij është zemra.

Kuptimi i nijetit është: vendosmëria e zemrës për të kryer një akt adhurimi për t'u afruar tek Allahu i Lartësuar.



Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

2



Larja e pëllëmbëve të duarve.



Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

3



Shpëlarja e gojës.

Si veprohet? E fut ujin në gojë dhe e rrotullon në të, pastaj e nxjerr jashtë (e pështyn).



Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

4



Thithja e ujit në hundë dhe pastaj nxjerrja e tij.

Thithja: Kjo përfshin tërheqjen e ujit në vrimat e hundës përmes frymëmarrjes.

Pastaj nxjerrja: Kjo përfshin nxjerrjen e sekrecioneve nga hunda nëpërmjet nxjerrjes së frymës.



Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

5



Larja e fytyrës.





Kufijtë e fytyrës:

Fytyra është ajo pjesë me të cilën ndodh përballja.

Gjerësia e saj: fillon nga veshi të veshi tjetër.

Gjatësia e saj: nga fillimi i flokëve normalë të kokës deri në fund të mjekrës.

Larja e fytyrës përfshin të gjitha qimet e holla në të, si dhe pjesën e lëkurës dhe qimet pranë kockës anësore të veshit.

Hapësira anësore e fytyrës është vendi midis qimeve pranë kockës anësore të veshit.

Qimet pranë kockës anësore të veshit janë ato që rriten mbi kockën e dalë anash faqes, paralelisht me vrimën e veshit, dhe shtrihen deri poshtë te vendi ku lidhet veshi me faqen.

Gjithashtu, larja e fytyrës përfshin çdo pjesë të dukshme të qimeve të dendura të mjekrës, së bashku me ato që varen poshtë saj.





Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

6



Larja e duarve nga majat e gishtave deri te bërrylat.

Bërrylat përfshihen në larjen e detyrueshme të krahëve.



Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8



Hapi

7

**Fshirja e gjithë kokës bashkë me
veshët vetëm një herë.**





Fillon nga pjesa e përparme e kokës, duke i lëvizur gishtat në pjesën e pasme të qafës; pastaj i kthen ato në pozicionin e tyre fillestar.

I fut gishtat tregues në veshë.

Pastaj përdor gishtat e mëdhenj për të fërkuar sipërfaqet e jashtme dhe të brendshme të veshëve.





Le të mësojmë hap pas hapi abdesin

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

8



Larja e këmbëve nga gishtërinjtë deri te nyjat. Nyjat përfshihen në larjen e detyrueshme të këmbëve.

Nyjat janë dy kockat e dala në pjesën e poshtme të këmbës.



Gjërat që e prishin abdesin:



**Çfarë del nga dy rrugët e
jashtëqitjes, si: urina, feçja,
gazrat, sperma etj.**

**Humbja e vetëdijes për
shkak të gjumit të thellë,
të fikët, dehjes ose
çmendurisë.**

**Çdo gjë që bën të
detyrueshme guslin,
si: xhunubllëku,
menstruacionet dhe
lehonia.**



Pasi njeriu kryen nevojat personale, ai duhet ta largojë papastërtinë ose me ujë të pastër -i cili është i preferueshëm -, ose me diçka tjetër përveç ujit të pastër që largon papastërtinë, siç janë: gurët, letrat, pëlhurat e gjëra të tjera të ngjashme me këto, me kusht që të bëhen së paku tre fshirje pastruese dhe me diçka të pastër e të lejuar.

المَسْحُ عَلَى الْخَفِيزِ وَالْجُورِيَّتِ

**Mes'hi (fshirja) mbi
mestet e lëkurës dhe
çorapet**





Nëse dikush vesh meste lëkure ose çorape të zakonshme, mund t'u japë mes'h atyre (ta fshijë dorën e lagur mbi to) pa pasur nevojë të lajë këmbët, pasi të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- 1 Ato duhet të jenë veshur pas një pastrimi të plotë nga papastërtia rituale e vogël (abdesi) dhe e madhe (gusli), teksa janë larë këmbët.
- 2 Ato duhet të jenë të pastra, jo të papastra.
- 3 Mes'hi duhet të bëhet brenda afatit të caktuar kohor.



4

Ato duhet të jenë fituar ligjërisht, pra të jenë të lejuara (jo të vjedhura apo të grabitura etj.).



Mestet e lëkurës: janë veshje për këmbën, të prodhuara prej lëkure të hollë ose materiale të ngjashme me të. Tipare shumë të afërta me këto kanë edhe këpucët që mbulojnë këmbët.



Çorapet : janë veshje për këmbën, që thuren me fije leshi, pambuku, me fije sintetike ose me diçka të ngjashme me këto.





Urtësia e ligjërit të mes'hit mbi çorape:

Është që t'u ofrojë lehtësim muslimanëve, t'ua largojë atyre vështirësinë e heqjes së çorapeve ose mesteve të lëkurës dhe larjes së këmbëve, veçanërisht gjatë dimrit dhe të ftohtit ekstrem, si dhe gjatë udhëtimit.





Koha e mes'hit:

Për rezidentin (ai që banon në një vend të caktuar, jo udhëtar): një ditë e një natë (24 orë).



Për udhëtarin: tre ditë e tre netë (72 orë).



Llogaritja e kohës nis nga mes'hi i parë mbi mestet e lëkurës apo çorapet pas prishjes së abdesit.

Faktorët që bëjnë mes'hin pavlefshëm:

1

Çdo gjë që e bën të detyrueshme guslin (larjen e plotë të trupit).

2

Përfundimi i periudhës kohore të mes'hit.



Si jepet mes'hi mbi mestet e lëkurës ose çorapet?

- 1 Lagni duart.
- 2 Kaloni dorën mbi majën e këmbës (nga majat e gishtërinjve deri në majë të kërcirit).
- 3 Fshini këmbën e djathtë me dorën e djathtë dhe këmbën e majtë me dorën e majtë.



الغسل

Gusli
(larja e plotë e trupit)





Nëse një burrë ose grua kryen marrëdhënie seksuale, ose nëse sperma ejakulohet prej tyre me epsh, teksa janë zgjuar ose në gjumë, ata duhet të marrin gusl (të lajnë gjithë trupin), në mënyrë që të mund të falin namazin ose të bëjnë çdo gjë që kërkon pastërti.

Po kështu, nëse një grua pastrohet nga menstruacionet dhe lehonja, ajo duhet të lajë gjithë trupin përpara se të falë namazin ose të bëjë çdo gjë që kërkon pastërti.





Përshkrimi i guslit është si më poshtë:

Muslimani duhet ta lajë të gjithë trupin e tij me ujë në çdo mënyrë të mundshme, duke përfshirë shpëlarjen e gojës dhe hundës. Pasi trupi (bashkë me kokën) të laget plotësisht me ujë, ai pastrohet nga papastërtia e madhe rituale, kështu është i pastër.



Personit që është në gjendje papastërtie rituale (xhunub) i ndalohet të kryejë adhurimet dhe veprimet e mëposhtme, derisa të marrë gusl:

- 1** Namazi.
- 2** Tauafi rreth Qabes.
- 3** Qëndrimi në xhami; këtij përsone i lejohet vetëm kalimi nëpër xhami.
- 4** Prekja e Kuranit.
- 5** Leximi i Kuranit.

التيمم


Tejemumi (pastrimi simbolik me dhe')





Nëse muslimani nuk mund të gjejë ujë për t'u pastruar, ose nuk është në gjendje ta përdorë atë për shkak të sëmundjes etj., dhe ka frikë se do ta humbasë kohën e namazit, atëherë duhet të marrë tejemum me dhe'.





Përshkrimi i marrjes së tejumumit:
Godet tokën një herë me të dyja duart, më pas fshin me to fytyrën dhe shuplakat (vetëm një herë). Dheu duhet të jetë i pastër.





Tejemumin e bën të pavlefshëm:

- 1** Çdo gjë që e bën të pavlefshëm abdesin.
- 2** Nëse gjendet uji para fillimit të aktit të adhurimit për të cilin është marrë tejemumi.

تَعَلَّمِ الصَّلَاةَ

Mësoj namazin





Allahu ia ka bërë obligim muslimanit
pesë namaze gjatë ditës dhe natës:
sabahun, drekën, ikindinë, akshamin
dhe jacinë.





Përgatitem për namaz:

Kur vjen koha e namazit, muslimani duhet të pastrohet nga papastërtitë e vogla dhe të mëdha rituale, nëse është në një gjendje papastërtie të madhe rituale.

Papastërtia e madhe rituale është ajo që ia bën muslimanit të detyrueshëm guslin (larjen e plotë të trupit).

Papastërtia e vogël rituale është ajo që ia bën muslimanit të detyrueshëm abdesin.

- Muslimani falet me rroba të pastra, në një vend të pastër, duke mbuluar trupin.
- Muslimani duhet të veshë rroba të përshtatshme gjatë namazit dhe ta mbulojë trupin me to. Burrit nuk i lejohet të zbulojë asgjë midis kërthizës dhe gjurit gjatë namazit.





- Gruaja duhet të mbulojë të gjithë trupin e saj gjatë namazit, përveç fytyrës dhe duarve.
- Gjatë namazit muslimani nuk thotë asgjë tjetër përveç fjalëve specifike që thuhën në të. Ai e dëgjon imamin me vëmendje dhe nuk kthehet majtas apo djathtas gjatë namazit. Nëse nuk është në gjendje t'i mësojë përmendësh fjalët specifike që thuhën gjatë namazit, atëherë ai e përmend Allahun, e lavdëron dhe e madhëron Atë, derisa ta përfundojë namazin. Ai e ka obligim të mësojë namazin dhe fjalët që thuhën gjatë kryerjes së tij.





Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

Hapi

4

1

5

6

Nijeti (qëllimi) për namazin e detyrueshëm që dua të kryej; dhe vendi i tij është zemra.

7

8

Pas abdesit, drejtohem nga Kibla dhe falem në këmbë, nëse kam mundësi.

9

10

11

12



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

2

I ngre duart në nivelin e shpatullave dhe them: “Allahu ekber” (Allahu është më i Madhi), me qëllim që të hyj në namaz.



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

3

Kur hap namazin, e them lutjen pas tekbirit fillestar, ashtu siç është transmetuar. Një prej transmetimeve është: “Subhānekall-llāhumme ue bihamdike ue tebārakesmuke, ue te’ālā xhedduke, ue lā ilāhe ġajruke.” (O Allah! Ti je pa të meta. Ty të bëj lavdi! Emri Yt është i bekuar, Madhëria jote është e Lartësuar, dhe askush pos Teje s’ka të drejtë të adhurohet!).



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9



Hapi

4

10

11

12

Kërkoj strehim tek Allahu nga shejtani i mallkuar, duke thënë:
“E’ūdhu bil-lāhi minesh-shejtānirr-raxhīm.” (I mbështetem Allahut të më mbrojë nga shejtani i mallkuar).



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

5

Lexoj suren el Fatiha në çdo rekat:
“Bismil-lāhirr-rraḥmānirr-rraḥīm.
(1) El-Hamdu lil-lahi rabil alemin,
(2) Er-Rahmanirr-Rrahim, (3) Maliki
jeumid-din. (4) Ijjake nabu ue ijake
nestein. (5) Ihdines-siratal mustekim,
(6) siratal-ledhine enamte alejhim,
gajril magdubi alejhim ueled-dalin. (7)”.



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

(Meemrine Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! (1) Të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve, (2) të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, (3) Sunduesit të Ditës së Gjykimit. (4) Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë. (5) Udhëzона në Rrugën e Drejtë! (6) Në rrugën e atyre që i begatove me të mira e jo në rrugën e atyre që merituan zemërimin (Tënd), as në rrugën e të humburve! (7)). Pas Fatihasë, lexoj çfarëdo (ajete apo sure) që kam mësuar nga Kurani vetëm në rekatin e parë dhe të dytë të çdo namazi. Kjo nuk është e detyrueshme, por duke vepruar kështu fitoj shpërblim të madh.



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Them: **“Allahu ekber”**, pastaj përkulem derisa shpina ime të drejtohet dhe duart e mia të jenë në gjunjë me gishtat e hapur, teksa përkulem them: **“Subhāne rabbijel ‘adhīm”** (tri herë)(I Dëlirë nga të metat është Zoti im, i Madhërishmi!).



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

7

Ngrihem nga rukuja, duke thënë: **“Semi’All-llāhu limen ḥamideh!”** (Allahu e pranon lavdinë e atij që i bën lavdi!), duke i ngritur duart në nivelin e shpatullave. Kur trupi im është drejt dhe në këmbë, them: **“Rabbenā ue lekel-ḥamd.”** (Zoti ynë, Ty të takon lavdia.).



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

8

Them: **“Allahu ekber”**; pastaj bëj sexhde me shtatë gjymtyrë: duart, gjunjët, këmbët, ballin e hundën, dhe them në sexhde: **“Subhāne Rabbijel a’ēlā.”** (tri herë) (I Dëlirë nga të metat është Zoti im, më i Larti.).



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

Hapi

9

9

Them: **“Allahu ekber”** dhe ngrihem nga sexhdja derisa qëndrojmë me shpinën drejt, duke u ulur në këmbën e majtë, ndërsa këmbën e djathtë e mbajmë drejt, dhe them: **“Rabbiğfirlî!”** (O Zoti im, më fal!).

10

11

12



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

10

Them: **“Allahu ekber”** dhe bëj sexhde përsëri si sexhdeja e parë.



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9



Hapi

11

10

Ngrihem nga sexhdeja duke thënë
“Allahu ekber”, derisa qëndrojt drejt.

11

12



1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

Pastaj veproj të njëjtën gjë në rekatet e mbetura të namazit, siç bëra në rekatën e parë. Pas rekatit të dytë të namazit të drekës, ikindisë, akshamit dhe jacisë, ulem për të thënë teshehudin e parë: **“Et-teḥijjātu lil-lāhi ueṣ-ṣaleeātu, ueṭ-ṭajjibātu, es-selāmu ‘alejke ejjuhen-nebijju ue raḥmetull-llāhi ue berakātuhu, es-selāmu ‘alejnā ue ‘alā ‘ibādil-lāhiṣ-ṣāliḥīn, eshhedu en lā ilāhe il-lAll-lāh, ue eshhedu enne Muḥammeden ‘abduhu ue rasūluhu.”** (Nderimet, madhështimet, lutjet dhe fjalët e dëlira i takojnë Allahut! Paqedhënësi (Es -Selamu) qoftë me ty, o i Dërguar, dhe po ashtu mëshira dhe begatimet e vazhdueshme të Tij! Paqedhënësi



1 qoftë me ne dhe me robërit e drejtë të
2 Allahut! Dëshmoj se nuk ka të drejtë
të adhurohet kush përveç Allahut, dhe
dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i
dërguar i Tij!)

3 Pastaj ngrihem për rekatin e tretë.
4 Pas rekatit të fundit të çdo namazi,
5 ulem për të thënë teshehudin e fundit:
6 **"Et-tehijjātu lil-lāhi ueş-şaleeātu,**
7 **ueţ-ţajjibātu, es-selāmu 'alejke**
8 **ejjuhen-nebijju ue raḥmetull-llāhi**
9 **ue berakātuhu, es-selāmu 'alejnā ue**
10 **'alā 'ibādil-lāhiş-şāliḥīn, eshhedu en**
11 **lā ilāhe il-lAll-llāh, ue eshhedu enne**
12 **Muḥammeden 'abduhu ue rasūluhu.**
All-llāhumme şal-li 'alā Muḥam-medin
ue 'alā āli Muḥammedin kemā şal-lejte
'alā Ibrāhīme ue 'alā āli Ibrāhīme, inneke
ḥamīdun Mexhīd. All-llāhumme bârik 'alā
Muḥammedin ue 'alā āli Muḥammedin,
kemā bârakte 'alā Ibrāhīme ue 'alā āli
Ibrāhīme, inneke ḥamīdun Mexhīd."
(Nderimet, madhështimet, lutjet
dhe fjalët e dëlira i takojnë Allahut!
Paqedhënësi (Es- Selamu) qoftë me
ty, o i Dërguar, dhe po ashtu mëshira
dhe begatimet e vazhdueshme të Tij!
Paqedhënësi qoftë me ne dhe me



robërit e drejtë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka të drejtë të adhurohet kush përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij! O Allah, lavdëroje (tek melekët e lartë) Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar. O Allah, begatoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar).

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Mësoj namazin hap pas hapi:

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12



Hapi

12

Në fund, jap selam në anën e djathtë, duke thënë: **“Es-Selamu alejkum ue rrahmetullah!”** (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju!). Pastaj jap selam në anën e majtë, duke thënë: **“Es-Selamu alejkum ue rrahmetullah!”** (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju!). Veprojnë në këtë mënyrë duke synuar të dal nga namazi. Kështu e kam kryer namazin.

حجاب المرأة المسلمة

Hixhabi (mbulesa)
i gruas muslimane





Allahu i Lartësuar thotë:
{O Profet! Thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtareve që të hedhin mbulesën! Kjo është mënyra më mirë që ato të njihen (se janë të ndershme) dhe që askush të mos i ngacmojë. Allahu është Falës i Madh e Mëshirëplotë} [El Ahzab: 59].





Allahu ia bëri obligim gruas muslimane hixhabin dhe mbulimin e të gjithë trupit para burrave të huaj (që nuk janë të afërm të saj), duke përdorur veshjen e zakonshme të vendit të saj. Gruas nuk i lejohej të heqë mbulesën, përveçse para bashkëshortit ose të afërmeve të saj. Të afërmit janë ata me të cilët martesë është e ndaluar përgjithmonë. Ata janë: babai dhe paraardhësit e tij (gjyshërit e çka sipër tyre -stërgjyshët), i biri dhe pasardhësit e tij (nipërit e çka poshtë tyre), xhaxhallarët e dajallarët, vëllai, djali i vëllait dhe djali i motrës, njerku, vjehërri dhe paraardhësit e tij, djali i burrit dhe pasardhësit e tij (nipërit e çka poshtë tyre), vëllai nga gjidhënia, burri i mëndeshës. Ndalohet nga gjidhënia gjithçka që ndalohet për shkak të lidhjes së gjakut.





Gruaja muslimane duhet të respektojë disa udhëzime në lidhje me veshjen e saj:

- 1. Veshja të mbulojë gjithë trupin.**
- 2. Të mos veshë rroba të stolisura (të zbukuruara).**
- 3. Të mos jetë veshje e tejdukshme, që shfaq trupin e saj.**
- 4. Të jetë e lirshme, jo e ngushtë, që shfaq trupin e saj.**
- 5. Të mos jetë i parfumuar.**
- 6. Të mos i ngjajë veshjes së burrave.**
- 7. Të mos i ngjajë veshjes së jomuslimaneve gjatë ritualeve ose festave të tyre.**



مِنْ صِفَاتِ الْمُؤْمِنِ

Cilësi të besimtarit





Allahu i Lartësuar thotë: {Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që, kur përmendet Allahu, u frikësohet zemra dhe, kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi. Ata kërkojnë mbështetje vetëm te Zoti i tyre}
[El Enfal: 2].





- Ai është i singertë; nuk gënjen.
- Është njeri besnik; e mban premtimin.
- Kur grindet me ndonjë, nuk është i dhunshëm.
- E çon në vend amanetin.
- Ai do për vëllain e tij musliman atë që do për vete.
- Është njeri bujar.
- U bën mirë njerëzve; i trajton mirë ata.
- Mban lidhjet farefisnore.
- Është i kënaqur me caktimin e Allahut; e falënderon Atë në kohë begatie dhe bën durim në ditë të vështira.
- Është njeri me cipë (i turpshëm).





- Është i mëshirshëm dhe i dhembshur ndaj krijesave.
- Ka zemër të pastër nga urrejtja; nuk i dëmton të tjerët.
- I fal njerëzit.
- Nuk e merr kamatën dhe nuk përshihet në këtë gjynah të madh.
- Ruhet nga imoraliteti.
- Nuk konsumon alkool.
- Është i sjellshëm me fqinjët e tij.
- Nuk bën padrejtësi e nuk tradhton.
- Nuk vjedh dhe nuk mashtron.
- Sillet mirë me prindërit, edhe nëse janë jomuslimanë; u bindet atyre në çdo gjë që është e drejtë (jo në mëkate).





- I edukon fëmijët me virtyte të larta; i urdhëron të përmbushin detyrimet fetare dhe i ndalon veprat e shëmtuara, veset dhe mëkatet.
- Nuk imiton veprimet e jomuslimanëve në praktikat ose zakonet e tyre fetare, që janë tipare ose simbole dalluese të besimit të tyre.



سَعَادَتِي فِي دِينِي الْإِسْلَامِ

**Lumturia ime
është në fenë time,
Islamin**





Allahu i Lartësuar thotë: {Kujtdo që bën një vepër të mirë, qoftë mashkull apo femër, duke qenë besimtar, Ne do t'i japim një jetë të mirë (në këtë botë), dhe (në Botën Tjetër) do t'i japim shpërblimin më të mirë për veprat e mira} [En-Nahl: 97].





Një nga gjërat më të mëdha që sjell gëzim, lumturi dhe kënaqësi në zemrën e muslimanit është lidhja e drejtpërdrejtë me Zotin, pa asnjë ndërmjetës nga të gjallët, të vdekurit apo idhujt. Allahu i Lartësuar në Librin e Tij të madhërishëm përmendi se Ai është gjithmonë afër robërve të Tij. Ai i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve të tyre, siç tha i Lartësuari: {Kur adhuresit e Mi të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam pranë (tyre). Unë i përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai më lutet. Le t'i përgjigjen thirrjes Time dhe le të më besojnë vetëm Mua, që të udhëzohen në rrugën e drejtë!} [El Bekare: 186].

Allahu i Lartësuar na urdhëroi ta lusim Atë, dhe e bëri këtë çështje një nga aktet më të mëdha të adhurimit me të cilat muslimani i afrohet Zotit, siç tha i Lartësuari: {Zoti juaj ka thënë: 'M'u lutuni Mua, që Unë do t'ju përgjigjem!} [Gafir: 60].

Muslimani i mirë ka nevojë të vazhdueshme për Zotin; i lutet





gjithmonë Atij dhe i afrohet gjithnjë me adhurime.

Allahu i Plotfuqishëm na krijoi në këtë univers për një urtësi të madhe. Ai nuk na krijoi kot. I Lartësuar na solli në këtë botë për ta adhuruar vetëm Atë, pa asnjë partner. Allahu ligjëroi për ne një fe hyjnore gjithëpërfshirëse, që rregullon të gjitha çështjet e jetës sonë private dhe publike. Me këtë sheriat të drejtë, Ai ruajti nevojat e domosdoshme të jetës sonë, që janë: feja, shpirti (jeta), nderi, mendja dhe pasuria. Kushdo që jeton duke zbatuar urdhërat hyjnorë dhe duke shmangur gjërat e ndaluara, pa dyshim që ruan këto domosdoshmëri rron i lumtur e i qetë.

Lidhja e muslimanit me Zotin është e thellë. Ajo i sjell prehje e rehati shpirtërore, një ndjenjë qetësie, sigurie dhe gëzimi. Kjo gjendje është rezultat i ndjenjës së pranisë së Zotit të Lartësuar e Fuqiplotë, i kujdesit të Tij dhe i mbrojtës e përkrahjes që Ai u jep robërve besimtarë. Allahu i





Plotfuqishëm thotë: {Allahu është Mbroytësi (i dashur) i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata prej errësirave në dritë} [El Bekare: 257].

Kjo marrëdhënie e fortë është një gjendje emocionale që e bën të kënaqet me adhurimin e të Gjithëmëshirshmit, të përmallohet për takimin me Të, dhe zemra t'i ngrihet lart në qiellin e lumturisë, duke e bërë të ndjejë ëmbëlsinë e besimit.

Kjo ëmbëlsi nuk mund të përshkruhet vetëm se nga ata që e kanë shijuar përmes akteve të bindjes dhe shmangies nga mëkatet.

Prandaj, Profeti Muhamed ﷺ tha: “E ka shijuar ëmbëlsinë e besimit ai që është i kënaqur me Allahun si Zot, Islamit si fe dhe Muhamedin ﷺ si të Dërguar të tij”.

Po, nëse një person e ndjen se është gjithmonë pranë Krijuesit të tij, e njeh Atë me emrat dhe cilësitë e Tij të bukura, e adhuron Atë sikur ta shohë, është





i singertë në adhurimin ndaj Tij dhe përmes këtij adhurimi dëshiron vetëm të fitojë kënaqësinë e Zotit, ai do të jetojë një jetë të mirë dhe të lumtur në këtë botë dhe do të jetë fatlum në Botën Tjetër.

Edhe fatkeqësitë që i ndodhin besimtarit në këtë botë lehtësohen nga qetësia e sigurisë, nga kënaqësia me caktimin e Allahut të Lartësuar dhe lavdërimi i Tij për gjithçka që ka caktuar, të mira dhe të këqija. Kjo ndjenjë gëzimi e lumturie i buron nga thellësia e zemrës.

Müslümanın mutluluğunun ve huzurunun artması için dikkat etmesi gereken şeylerden biri de Allahu Teâlâ'yı çokça zikretmesi ve Kur'ân-ı Kerîm'i okumasıdır. Nitekim Yüce Allah şöyle buyurmuştur: {Onlar inanmış olanlar ve kalpleri Allah'ı anmakla huzur bulan kimselerdir. Dikkat edin! Kalpler ancak Allah'ı anmakla huzur bulur} [Ra'd, 28]. Müslüman, Allah'ı zikrini ve Kur'ân okumasını artırdıkça, Allahu Teâlâ ile olan bağı güçlenir, nefsi temizlenir ve îmânı kuvvetlenir.





Aynı şekilde, Müslüman'ın, Allahu Teâlâ'ya basîret üzere (bilinçli bir şekilde) ibâdet edebilmek için dîninin meselelerini doğru kaynaklardan öğrenmeye gayret etmesi gerekir. Nitekim Nebî (Sallallâhu aleyhi ve sellem) şöyle buyurmuştur: "İlim talep etmek her Müslüman üzerine farzdır".

Ai duhet të jetë gjithmonë i nënshtruar dhe i bindur ndaj urdhrave të Allahut, i Cili e krijoi, pavarësisht se e kupton apo jo urtësinë që fshihet pas tyre. Allahu i Lartësuar në Librin e Tij të madhërishëm thotë: {Kur Allahu ose i Dërguari i Tij vendosin një çështje, nuk i takon (nuk i lejohet) besimtarit dhe besimtares që të gjejnë ndonjë gjykim tjetër në të. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, është në rrugë krejt të gabuar} [El Ahzab: 36].

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhamed, familjen dhe të gjithë shokët e tij.



Përmbledhje e dobishme për muslimanin e ri



Përgatiti
Muhammed esh-Shehri



Libër interaktiv për
celular



Kliko mbi figurë për t'u
kthyer te kopertina